



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Durrës 21.01.2026

Lënda : Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

1. Pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Durrës, nuk rezulton asnjë biznes i regjistruar si "Shoqatë e gjuetarëve" taksa pagues i rregullt.
2. Pas hyrjes ne fuqi te ligjit Nr. 89/2025 "PËR GJUETINË", ne zbatim te nenit 10, pika 1 "Strukturat përgjegjëse për natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me shoqatat dhe federatat, që operojnë në fushën e gjuetisë, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i propozojnë ministrisë përgjegjëse për gjuetinë zonat e gjuetisë dhe kufijtë." Po ju bejme me dije se : Bashkia e Durresit nuk ka nje plan paraprak lidhur me menaxhimin e zonave te gjuetise. Struktura pergjegjese qe do te caktohet do kryej propozimet per caktimet e zonave te gjuetise brenda afateve ligjore ne instancat perkatese.